



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Sabri Azemi" B.I. të datës 09.07.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 05.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave në objektin komunal dhe institucionet tjera" me nr. të prokurimit 616-24-5477-1-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRATOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Sabri Azemi" B.I. të datës 09.07.2024 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 05.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave në objektin komunal dhe institucionet tjera" me nr. të prokurimit 616-24-5477-1-2-1 ashtu që **ANULOHET** njoftimi mbi vendimin i datës 05.07.2024 i autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të dërgoj në **RIVLERËSIM** aktivitetin e prokurimit nga pika I e këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Sabri Azemi" B.I. (tutje "parashtruesi") me datë 09.07.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 05.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimave në objektin komunal dhe institucionet tjera" me nr. të prokurimit 616-24-5477-1-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi nr. 1 – “Udhëheqësit të punishtes - bachelor ose inxhinier i dip. i termoenergjetikës i mungojnë CV e nënshkruar dhe së paku një kontratë të ngjashme të realizuar në tri vitet e fundit”.

Pretendimi nr. 2 – “OE i propozuar për kontratë në ofertën e tij si inxhinier të hidroteknikës ka ofruar inxhinierin Xhevat Binaku për të cilin në dëshmitë e tij të ofruara dyshohet se ka bërë falsifikim të nënshkrimit”.

Pretendimi nr. 3 – “OE i propozuar për kontratë për vlerësimin e rrishtit në ofertën e tij ka paraqitur vetëm 3 pozita: administratorja, drejtori dhe serviseri i pajisjeve shtëpiake”.

Pretendimi nr. 4 – “OE i propozuar për kontratë ka ofruar me cmime abnormalisht të ulëta në pozicionet 43, 44 dhe 66 të paramasës”.

Lidhur me pretendimin nr. 1 – nga administrimi me ofertën e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se tenderuesi i rekomanduar nuk ka dorëzuar CV e nënshkruar nga udhëheqësi i punishtes dhe së paku një kontratë të ngjashme të realizuar në 3 vitet e fundit sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Po ashtu mungon edhe vendimi për udhëheqësin e punishtes. Prandaj pretendimi është i bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 2 – AK nuk ka as kompetencë ligjore dhe as kapacitete teknike apo profesionale për të hetuar dyshimin e parashtruesit lidhur me falsifikimin e nënshkrimit. Lidhur me këtë parashtruesi ka mundësi që të drejtohet te organet kompetente sipas ligjeve përkatëse në fuqi.

Lidhur me pretendimin nr. 3 - nga administrimi me ofertën e tenderuesit të rekomanduar është gjetur se tenderuesi i rekomanduar ka dorëzuar raportin e vlerësimit të riskut vetëm për pozitat e cekura nga parashtruesi. Në anën tjetër ka dorëzuar një listë të stafit ku përfshihen edhe pozita të tjera përveç atyre që potencohen në raportin e vlerësimit të riskut. Me këtë rast komisioni vlerësues ka pasur mundësinë që të kërkojë sqarime shtesë nga tenderuesi i rekomanduar për të kuptuar se cilat janë arsytet e mospërputhjes mes listës së stafit dhe raportit për vlerësimin e riskut. Prandaj pretendimi është pjesërisht i bazuar.

Lidhur me pretendimin nr. 4 - komisioni vlerësues me rastin e rivlerësimit duhet të analizojë pozicionet e cekura nga parashtruesi dhe të konstatojë nëse janë plotësuar kushtet nga neni 41.3 dhe/ apo 41.4 i RRPP dhe rrjedhimisht të veprojë sipas nenit 41.6, 41.8, 41.9, 41.10 dhe 41.11 i RRPP.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP.

Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 15.07.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës



Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.